



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. të datës 15.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut në Kalabri – Faza II” me nr. të prokurimit 616-23-12168-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. e datës 15.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut në Kalabri – Faza II” me nr. të prokurimit 616-23-12168-5-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 13.12.2023 për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 15.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut në Kalabri – Faza II” me nr. të prokurimit 616-23-12168-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**Pretendimi i parë (I)** - “Duke parë raportin përmbledhës të vlerësimit verehët qartë që AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka bërë shkelje esencilae të ligjit të prokurimit publik, neneve të cekura më lartë për faktin se AK gjatë vlerësimit dhe udhëheqjes së procedurës ka mundur të kërkoj nga ne që për pikat e cekura me lartë të kërkojë dokumentacionet sipas nenit 72. e që nderlidhen me nenet 69-70 të LPP-së. Ne si OE Plotësojmë të gjitha kërkesat e dhëna në dosjën e tenderit dhe në FDT. CV e ngarkuara në platëformë deshmojnë punët dhe përvojën e inxhinierve tonë, në fushat e kërkuara sipas kërkesave të FDT-së. Vlerësimi i komisionit vlerësues se: ▪ Tek aneksi 1 I specifikimeve teknike mungon certifikata EN 1176- 4. Sqarojmë sipas LPP-së AK ka të drejtën të sigurohet që për produktet apo shërbimet të kërkoj nga OE që të sigurojnë AK me standarde të cilësisë. Prandaj, sqarojmë si më tej. Standardi i produkteve EN1176 është standard evropian i cilësisë dhe se në momentin që merrët si standard EN-1176 është konformë dhe i barasvlefshëm për të gjithë nenstandartet EN-1176-1 deri në EN-1176-11. Prandaj duke qenë se ne kemi dorëzuar standardin EN-1176 ne kemi plotësiar standardet tjera të cilësisë sa i përket EN-1176 dhe se është i vetmi standar që kërkohet ne EUROPE dhe AK gjatë vlerësimit të ofertës tonë ka vlerësuar gabim sa i përket edhe kësaj pike” .

**Pretendimi i dytë (II)** - “Pra siq shihet edhe këtu AK në asnjë rast nuk kërkon që OE duhet të lëshoj një letër garancie apo çfarëdo deklarate me të cilin garanton punimet. AK ka qenë e qartë në Aneksin 6 në minimumin e garancisë së punimeve. Pra 3 vite. Në rastë se një OE nuk bënë ndonjë deklaratë por ka dhënë deklaratë nën betim dhe deklaratë për specifikime teknike nënkupton se pajtohet me kërkesat e dosjës së tenderit në minimumin e kërkuar. Kërkesa për një garancion të tillë nuk ka qenë dhe nuk është decidivoe. AK gjatë vlerësimit të ofertave për OE që nuk kanë dhënë një deklaratë apo një letër garancie gjatë peshimit të çmimit të ofruar duhet të marrë minimumin e garancisë dhe të peshojë në përqindje” .

Lidhur me pretendimin e parë ankimor, fillimisht duhet sqaruar se arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit janë se mungojnë referencat për udhëheqësin e punishtes dhe inxhinierin e diplomuar të arkitekturës, pastaj mungojnë dokumentet për konfirmimin e marrëveshjes me lulishten Labi, marrëveshja me prodhuesin e produkteve sipas katalogut të dorëzuar, mungon certifikata EN-1176-4 si dhe mungon garancioni i punimeve minimumi 3 vite. Lidhur me arsyet për eliminimin e parashtruesit shih figurin si në vijim:

Komisioni i vlerësimit ka konstatuar disa të gjetura nga vlerësimi i ofertës së vetme të dorëzuar:

- Beqir Berisha- Udhëheqesi i punishtes – Planifikues Urban dhe Hapësinor-5 vite pervoje pune pas diplomimit – I mungojne referencat edhe pse ne CV I ka te listuara;
- Genta Deva - Inxhinier i diplomuar i arkitekures me 5 vite pervoje pune pas diplomimit – I mungojne referencat edhe pse ne CV I ka te listuara;
- Operatorit ekonomik I mungon marreveshja me lulishten Labi;
- Operatorit ekonomik I mungon marreveshja me prodhuesin e produkteve, katalogun e te cilit e ka bashkengjitur
- Tek aneksi 1 I specifikimeve teknike mungon certifikata EN 1176-4;
- Mungon garancioni pas perfundimit te punimeve, minimum 3 vite;

OE I mungojme dokumentet per ta konsideruar te pergjegjshme, OE nuk e ka plotesuar si duhet FDT, OE nuk I ka plotesuar si dihet nenkriteret e FDT, nuk ka dhene garancion te punimeve, ky eshte nje kriter qe nuk mund te kerkohet sqarime shtese parandaj oferta eshte e papergjegjshme.

Përveç arsyes së fundit të eliminimit (mungesës së garancionit të punimeve për të cilin do të elaborohet në pretendimin e dytë), për të gjitha arsyet tjera komisioni vlerësues ka pasur mundësi që të kërkoj sqarime shtesë nga parashtruesi në kuptim të nenit 72 të LPP si dhe pikës 10 të UPP.

#### 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 *Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së*

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkojen informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkojen informata sqaruese	69
Mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit	Mund të kërkojen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkojen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund të kërkojen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund të kërkojen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund të kërkojen informata sqaruese	69

Vlen të shtohet se anulimi i një aktiviteti të prokurimit duhet të vjen të konsideratë vetëm atëherë kur të shtjerren të gjitha mundësitë tjera sipas LPP për evitimin e mundësisë së anulimit. Në rastin konkret duhet marrë parasysh që parashtruesi është operatori ekonomik i vetëm i cili ka shprehur interesim për të tenderuar në këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj nuk ka asnjë arsye logjike apo ligjore që të mos kërkojen sqarime shtesë me qëllim që të shtjerren të gjitha mundësitë ligjore për evitimin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Nga ky kënd i vështrimit, pretendimet ankimore të parashtruesit janë të bazuara ndërsa komisioni për rivlerësim detyrohet që të kërkoj nga parashtruesi sqarime shtesë lidhur me të gjitha arsyet e eliminimit (përveç garancionit të punimeve për të cilin do të flitet në vijim në kuadër të përgjigjes mbi pretendimin e dytë ankimor).

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor, fillimisht duhet sqaruar se deklarata mbi garancionin e punimeve nuk është kërkesë e dosjes së tenderit e përcaktuar në mënyrë shprehimore. Me këtë rast nuk duhet ngatërruar deklaratën mbi garancionin e punimeve

me deklaratat tjera të ngjashme siç janë deklaratat nën betim apo garancioni për ekzekutimin e tenderit apo garancioni mbi mbajtjen e parasë. Sidoqoftë, mungesa e deklaratës mbi garancionin e punimeve nuk përbën shkelje të dosjes së tenderit sikurse është konstatuar nga komisioni vlerësues. Kjo për arsye se ky dokument nuk është kërkuar në mënyrë shprehimore në dosjen e tenderit dhe nuk në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet në dëm të tenderuesve (sikurse të kishte qenë kërkesë e FDT pa qenë fare)

Megjithatë kriteri i dhënies së këtij tenderi ka qenë oferta ekonomikisht më e favorshme ku vlerësimi duhet të bëhet mbi bazën e dy nënkritereve vlerësuese si në vijim:

1. Çmimi me 70% të peshës së vlerësimit, si dhe
2. Garancioni punimeve nga 3 deri në 7 vite me 30% të peshës së vlerësimit.

<input checked="" type="checkbox"/> <b>Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të</b>		
	<b>Nënkriteret</b>	<b>Koeficient</b>
1	<b>Çmimi</b>	<b>0.70</b>
2	<b>Garancioni min 3 vjet=0%</b>	<b>0.30</b>

Në rastin konkret nuk është kontestues fakti që nuk është dorëzuar garancioni i punimeve. Prandaj komisioni i rivlerësimit të ky nënkriter duhet të bëjë vlerësimin me zero (0) pikë. Megjithatë nëse marrim parasysh faktin që parashtruesi është tenderuesi i vetëm dhe rrjedhimisht ka ofertuar me çmimin më të lirë, kjo nënkupton që i njëjti do të duhej të vlerësohej me pikët e caktuara sa i përket nënkriterit të parë (çmimit). Në cilindo rast komisioni për rivlerësim duhet të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertës së parashtruesit në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe kriterin e dhënies të përcaktuar me këtë dosje të tenderit. Prandaj pretendimi i dytë ankimor është i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet ankimore. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP. Prandaj është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 26.12.2023**

**Visar SHEHU**  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.